



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 33-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 16.03.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Lulzim Rrustemi
3. Egzona Fazlija
4. Naxhije Gashi
5. Arben Salihu
6. Slavisa Trajkovic
7. Zoran Çirković
8. Franjo Goleme

Të tjerë prezent

1. Ledija Jovanovic-ZLK
2. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-sherbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informatë nga Drejtorati për Shërbime publike rreth projekteve për vitin 2021
3. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 32-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 32-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Informatë nga Drejtorati për shërbime publike rreth projekteve për vitin 2021

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, tha se ftesa i'u ka shku drejtorit të DPSH nga sektori i kuvendit, mirëpo askush nuk ka marrë pjesë. Unë ne emër të komitetit jepi vërejtjet tona për këtë drejtorat pasi që të paktën ka mund të jetë prezent ndonjë zyrtar nga DPSH.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, u kalua në pikën e radhës.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Ledija Jovanovic nga ZLK e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZLK-së

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Zoran Cirkovic, kam një pyetje për një familje në Grackë me mbiemrin Muji.

Si shkon procedura a mundet të aplikoj prapë.

Lidija Jovanovic, ne si zyre jemi për t'i njoftuar të gjithë si duhet aplikuar, mirëpo jemi që të ketë ndarje të barabartë për të gjithë, pasi që kjo familje njëherë ka qenë përfituese.

Lulzim Qerimi, familja e Sabit Mujit ka qenë përfituese e mjeteve bujqësore .

Lulzim Rustemi, e falënderoj Lidijen për raportin dhe punën që po e bëjnë, e sa i përket familjes Muji nëse ajo ka përfituar një herë ndihmë nuk kemi nevojë ne si komitet çdo seancë me u marrë me ta, ka përfitu një herë tash le të përfitojnë të tjerët.

Sa i përket familjes Gashi nga Janjeva a janë marrë masa prej komunës dhe a jeni interesu për atë familje pasi që aty janë duke u rrezikuar një familje e tërë dhe dikush duhet t'u jep përgjegjësi.

Skender Bikliqi, ajo familje është në gjendje jo të mirë pasi që rrezikohen e gjithë familja. Por duhet urgjentisht të largohen nga ajo pjesë por unë së bashku me Lulin nënkryetarin

do të shohim që të ja bëjmë një zgjidhje, ta largojmë nga ai vend, ta dërgojmë në një shtëpi tjetër.

Lulzim Qerimi,ajo familje është e rrezikuar por për momentin nuk kemi mundësi ne si Komunë t'i bëjmë zgjidhje,pasi që ajo familje nuk ka pronë në emër të vetin.

Pastaj kësaj pike u kalua në pikën të ndryshme

IV Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, tha se a ka dikush të diskutoj rreth kësaj pike.

Sllavisha Trajkovic,unë do të kthehem prapë te pika e dytë ku nuk ke prezent drejtori i DPSH-s,i cili është dashtë të jetë prezent,por unë i falënderoj për punën që po e bëjë ai drejtorat në veçanti për pastrimin e varrezave qe është bërë një punë shumë e mirë. Po ashtu i falënderoj edhe zyrtarët e ZLK-s për raportin dhe punën që po e bëjnë.

Zoran Cirkovic,unë e kam një replikë të vogël ndaj Lulit pasi që unë e pata qëllimin me ditë si shkon procedura për aplikim por nëse familja Muji ka qenë fituese një herë nuk ka të drejt prap me përfitu.

Unë e kam edhe një shqetësim të banorëve të fshatit Grackë ku një banor i cili tani po jeton në fshatin Grackë del të shëtitë me biçikletë nëpër fshat dhe dy qenë të llojit pitbull po i len të lirë pa qenë të lidhur dhe me këtë po i rrezikon banorët e fshatit.

Deri para disa muajve ka qenë prezent policia në fshat dhe është interesua për shqetësimet e qytetarëve por tash qe një kohë nuk janë parë policia.

Lulzim Qerimii ,ky shqetësim duhet të ngritët në KKSB pasi që në atë këshill diskutohet rreth sigurisë në Vend dhe aty marrin pjesë të gjithë përfaqësuesit e sigurisë dhe të komiteteve.

Franjo Goleme,edhe në Janjëvë kemi të njëjtin problem ku një grua e moshuar mban një qen edhe ajo po i rrezikon banorët nga qeni i saj

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14³⁰.

**Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu**

**Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi**